

Administratori i UK-së, përveç sa është përcaktuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ushtron edhe këto funksione:

1. Harton planin buxhetor afatmesëm të UK-së.
2. Harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të universitetit, si dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij.
3. Propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen dhe zbatimin e tyre.
4. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të universitetit në strukturat e varësisë së tij.
5. Përgjigjet për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të universitetit, me përjashtim të kompetencave ekskluzive të Bordit të Administrimit.
6. Zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ.
7. I paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të universitetit në përfundim të vitit akademik.
8. Plotëson kërkesat e Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.
9. Bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të universitetit për çështje të administrimit të përditshëm.
10. Emëron dhe shkarkon administratorët e njësive kryesore dhe njësive bazë, pas miratimit të Bordit të Administrimit.
11. Thërret për raportim përgjegjësit e strukturave administrative që ka në varësi.
12. Shfuqizohet/hiqet.
13. Organizon dhe drejton kryerjen e veprimtarive për shërbimet ndaj të tretëve.
14. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurave të prokurimit dhe ankandeve që zhvillon institucioni, përkatësisht sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi për prokurimet dhe ankandet, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
15. Është përgjegjës direkt për performancën administrative dhe financiare të UK-së dhe/ose njësive të tjera të tij, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
16. Është përgjegjës për veprimtarinë e përgjithshme administrative dhe financiare të UK-së, për vendosjen dhe drejtimin e politikave dhe procedurave në mënyrë që të sigurojë në kohë dhe në mënyrë profesionale përmbushjen e detyrave, në formulimin dhe zbatimin e politikave të UKsë.
17. I paraqet për miratim Bordit të Administrimit, rregulloren financiare, strukturën dhe kriteret e emërimit të punonjësve administrativë.
18. Emëron dhe shkarkon personelin administrativ të UK-së, në përputhje me kriteret, organikën e miratuar dhe legjislationin në fuqi.
19. Nënshkruan kontratat e punës së personelit administrativ.
20. Kontrollon zbatimin e rregullave të etikës nga personeli administrativ dhe merr masat e duhura disiplinore ndaj shkeljeve të konstatuara.
21. Nënshkruan dokumentet e hartuara me karakter administrativ dhe financiar, që dalin në emër të UK-së.
22. Nxjerr urdhra dhe akte të tjera në funksion të drejtimit të veprimtarisë administrative e

financiare të institucionit.

23. Funksione të tjera të Administratorit përcaktohen në rregulloret e UK-së.